



**Peace  
Corps**

NORTH MACEDONIA

# Raporti Vjetor 2019





**Peace Corps**



Mark Hannafin

Drejtor i Korpusit të Paqes  
në Maqedoninë e Veriut

*(Ish-vullnetar në Kirgizistan, 1993-1995)*

Jam krenar të paraqes raportin vjetor të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut për vitin 2019. Gjatë këtij viti Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut është rritur për nga numri i vullnetarëve që shërbejnë këtu, komunitetet në të cilat ata punojnë, familjet me të cilat vullnetarët tanë jetojnë, si edhe për nga stafi ynë i shkëlqyeshëm që i përkrah. Ne krijuam partneritete të shkëlqyeshme me Rotary International, Shoqatën e Skautëve dhe Kryqin e Kuq. Me shtimin e MAK 24 në shtator dhe betimin e tyre në fillim të dhjetorit, rradhët tona vullnetare u rritën në mbi 100 në tërë shtetin. Ne vazhduam të orientojmë vullnetarët tanë të rinj përmes partneritetit tonë të shkëlqyeshëm me Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë dhe inaguruam Gostivarin si një vend të ri trajnimi me bazë komunitare, së bashku me qytezat e mrekullueshme të Rosomanit, Sveti Nikollës, Llozovës dhe Negotinës. Vullnetarët tanë zotëruan maqedonishten ose shqipen në nivele të përparuara, si kurrë më parë. Ata vazhduan të shërbejnë në fshatrat, qytezat dhe qytetet e tyre me programim inovativ në aftësi rinore, me klasa të veçanta në shkolla, klube të vajzave dhe djemve dhe koncerte dhe performanse për fëmijë me nevoja të veçanta. Ambasadorja e sapoarritur e SHBA-ve, e nderuara Kate Marie Byrnes na është bashkangjitur në disa raste që të mbështet vullnetarët, duke përfshirë këtu edhe evenimentin për

përfundimin e shërbimit për grupin MAK22, kampin e Programit Udhëheqës të të Rinjve në Krushevë dhe disa vizita për të parë vullnetarët e vitit të tretë që përforcojnë partneritetet e tyre në nevoja të veçanta dhe zhvillim të komunitetit. Ne ishim nikoqirë të takimeve të nivelit të lartë me përfaqësues të Departamentit të Shtetit dhe USAID-it, para të cilëve theksuam punën që vullnetarët po e bënin me partnerët e tyre lokal. Ne jemi thellësisht falenderues për përkrahjen që e marrim nga ajo dhe nga i tërë komuniteti i Ambasadës dhe stafi diplomatik.

Përgjatë vitit 2019 Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut zgjeroi integrimin tonë në komunitetet në të cilat shërbejmë. Ne nënshkruam një memorandum me Byron për zhvillimin e arsimit dhe tani trajnimet tona janë të akredituara për mësuesit e anglishtes në të gjithë vendin. Ne i siguruam një grant Këshillit Rinor Kombëtar për të ndërmarrë një vlerësim inovativ të udhëhequr nga të rinjtë për grantet tona të vogla të ndihmës USAID-Korpusi i Paqes, duke forcuar njohurit e tyre për qëndrueshmërin e granteve. Ekipi ynë programor përfundoi një përmbledhje të programit tonë të mësimdhënies në gjuhën angleze, programit të nevojave të veçanta me partnerët tanë të ministrive për programim të bazuar në nevoja në lidhje me përparësitë e qeverisë. Vullnetarët mbajtën 17 kampe ditore me bazë komunitare dhe angazhuan më shumë se 900 të rinj në aktivitete që nuk ishin larg shtëpive të tyre dhe përmirësuan aftësitë e tyre të jetesës dhe i bënë të mendohen rreth botës përreth tyre. Në zyrën tonë, ne mirëpritëm disa punëtorë të rinj të shquar dhe vazhduam programin tonë të internshipit, duke përfshirë këtu mikun tonë Okin, një djalë i ri me Sindromën Downs i cili solli frymëzim dhe punë të palodhur në jetën tonë çdo javë. Brenda këtyre faqeve do të mësoni më shumë rreth numrave dhe tregimeve pas numrave. Shpresoj që do të ju pëlqej të mësoni për punën që ne po bëjmë dhe se si ne të gjithë mund të kontribuojmë në të ardhmen e paqes dhe miqësisë mes kombeve tona.

# Shkurtimisht për Korpusin e Paqes

Në vitin 1961, Kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhon F. Kenedi, formoi Korpusin e Paqes për të promovuar paqen dhe miqësinë botërore dhe sfidoi amerikanët për të jetuar dhe punuar në vendet në zhvillim. Kaluan më shumë se pesëdhjetë e tetë vjet nga formimi i Korpusit të Paqes, por misioni dhe roli i Korpusit të Paqes i bëri ballë testit dhe kohës. Tre qëllimet e Korpusit të Paqes mbeten po aq të rëndësishme aq sa ishin kur u formua ai:



- Qëllimi 1: Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuar të përmbushin nevojat për individë të trajnuar.
- Qëllimi 2: Të promovojë kulturën dhe vlerat amerikane te vendet në të cilat vullnetarët shërbejnë.
- Qëllimi 3: Të promovojë në Amerikë kulturën dhe vlerat e vendeve në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Nga viti 1961, më shumë se 235 000 vullnetarët të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në 141 vende, dhe kanë lënë trashëgimi vlera të përbashkëta, marrëdhënie të përmirësuara dhe zhvillim të qëndrueshëm në komunitet. Në vitin 2019 më shumë se 7300 amerikanë kanë qenë vullnetarë në 61 vende nëpër tërë botën.

# Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut

Grupi: MAK 1, 1996



Korpusi i Paqes formoi programin e tij në Maqedoninë e Veriut në vitin 1996, me ftesë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Që atëherë, më shumë se 800 vullnetarë kanë shërbyer në shkolla, komuna, organizata qytetare dhe institucione publike për të përmbushur nevojat e ndryshme të komuniteteve në vend. Si mirënjohje për rëndësinë e Korpusit të Paqes për përmirësimin e miqësisë maqedonase-amerikane dhe për detyrimin dhe përkushtimin e vullnetarëve në shoqërinë maqedonase, kryetari i Maqedonisë

së Veriut dhuroi Urdhërin e Meritës për Korpusin e Paqes në Maqedoninë e Veriut në vitin 2011. Në vitin 2019 gjithsej 109 vullnetarë kanë shërbyer në njërin nga dy projektet e Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut, programin për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programin për zhvillimin e komunitetit, me fokus të veçantë në të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë shërbimit të tyre në Maqedoni, vullnetarët njihen me kulturën lokale, mësojnë gjuhët lokale dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në jetën shoqërore. Pas mbërritjes në Maqedoninë e Veriut, vullnetarët kalojnë nëpër një trajnim intenziv për gjuhën, kulturën dhe shkathtësitë teknike. Për të lehtësuar integrimin e tyre në komunitetet lokale, vullnetarët jetojnë me familje nikoqire lokale gjatë trajnimit fillestar, por edhe gjatë periudhës prej 6 deri 24 muaj të shërbimit të tyre. Korpusi i Paqes ka bërë implementimin e programit të tij në Maqedoninë e Veriut përmes bashkëpunimit direkt me disa partnerë shtetërore dhe lokal të cilët janë aktiv në sferën e arsimit, zhvillimin e komunitetit, punën me të rinjtë dhe personat me nevoja të veçanta.



Grupi: MAK 24, 2019

Në vitin 2019, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut kishte Memorandum për Mirëkuptim me: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Byronë për zhvillim e arsimit, Agjencionin për rini dhe sport, Kryqin e Kuq, Këshillin Nacional Rinor dhe Koalicionin e organizatave rinore "SEGA", Shoqatën e Skautëve dhe Shoqatën e Klubeve Rotary në Maqedoninë e Veriut.



# KORPUSI I PAQES NË VITIN 2019

Peace Corps

2

projekte të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut - programi për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programi për zhvillimin e komuniteteve

89

familje nikoqire me të cilat vullnetarët jetuan

19

vullnetarë që shërbyen në organizata dhe institucione për njerëzit me nevoja të veçanta

109

vullnetarë të Korpusit të Paqes shërbyen në Maqedoninë e Veriut

24

vite të Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut

114

arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme kanë bashkëpunuar me vullnetarët

26

projekte në komunitet, implementimi i të cilave është bërë përmes programit për grante të vogla të Korpusit të Paqes

128

persona me nevoja të veçanta me të cilët kanë punuar vullnetarët

44

vullnetarë shërbejnë në OJQ, komuna dhe institucione publike

180

individë kanë përmirësuar kualitetin e jetesës përmes aftësive të përmirësuara të jetës ose rritjes së angazhimit në komunitet

56

komuna në të cilat vullnetarët kanë jetuar dhe shërbyer

1099

individë ishin pjesë e aktiviteteve për pjesëmarrje në komunitet

65

shkolla fillore dhe të mesme ku vullnetarët kanë shërbyer

6267

persona, shumica të rinj, të cilët morrën pjesë në aktivitete për pjesëmarrje në komunitet, fitimin e shkathësive jetësore dhe vullnetarizëm

66

mësimdhënës punuan me vullnetarët në zhvillimin e metodologjive për punë me nxënës me nevoja të veçanta

10219

nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të cilët kanë mësuar me ndihmën e një vullnetari

## Projekti i Zhvillimit të Komunitetit

Projekti i zhvillimit të komunitetit në Maqedoninë e Veriut mbështet komunitetet dhe organizatat në vend me qëllim të arritjes së një zhvillimi më efikas të qëndrueshëm të komuniteteve.

Në vitin 2019 vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë punuar me organizatat qytetare, komnat lokale dhe institucionet publike të vendit.



Duke punuar me partnerët lokal qëllimi i projektit të zhvillimit të komunitetit është që të ketë qytetarë aktiv dhe të angazhuar dhe organizatat e komunitetit në Maqedoninë e Veriut të udhëheqin përpjekje të qëndrueshme të zhvillimit që janë përfshirëse dhe të gjithë kategoritë e qytetarëve të përfitojnë nga ato.

Në vitin 2019 Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut e zgjeroi rrjetin e partnerëve duke nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e Skautsave. Gjithashtu Korpusi i Paqes e thelloi bashkëpunimin e tij me Shoqatën e Rotary klubeve duke e rritur numrin e bashkëpunimeve direkte në mes të klubeve dhe vullnetarëve në 6 komunitete.

Vullnetarët për zhvillim të komunitetit në Maqedoninë e Veriut dhe bashkëpunëtorët e tyre lokal në vitin 2019 iu dhanë përparësi pojekteve në vijim:

- Mbështetja e organizatave në përcaktimin e nevojave të komunitetit dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike për t'ju përgjigjur nevojave të identifikuar;
- Përmirësimi i shkathtësive të punonjësve në fushat e rëndësishme për zhvillimin organizativ;
- Trajnimet e qytetarëve me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në komunitet dhe fitimit të shkathtësive jetësore, si dhe ngritjes së ndërgjegjes për personat me aftësi të kufizuara;
- Lehtësimi dhe organizimi i aktiviteteve për zhvillimin e shkathtësive jetësore tek të rinjtë, klubet rinore dhe kampet GLOW dhe YMLP, programet e udhëheqjes qytetare, si edhe Modelin e Kombeve të Bashkuara.

## Projekti për përparimin e mësimdhënies në gjuhën angleze

Vullnetarët në projektin për përparim të mësimdhënies në gjuhën angleze kanë punuar në shkolla fillore dhe të mesme, kryesisht me theks në komunitetet rurale dhe ato të marginalizuara. Vullnetarët e mësimdhënies në gjuhën angleze i kanë ndihmuar arsimtarët në klasë duke i njohur me metodologji klasore të përqëndruara tek nxënësit, qasje të reja në menaxhimin e klasës dhe ndihmë me klasa me shumë nivele. Përveç kësaj, kishte vullnetarë për nevoja të veçanta të vendosur në shkolla fillora që bashkëpunonin me edukatorët special në shkolla duke ndihmuar në përpjekje për praktika përfshirëse në shkollë.



Gjatë vitit, Korpusi i Paqes kishte rishqyrtuar përmbledhjen gjithëpërfshirëse të programit

të mësimdhënies në gjuhën angleze dhe të programit për nevoja të veçanta, i cili ishte i përfshirë në programin për zhvillim të komunitetit, dhe në shtator ishte vendosur që këto dy të bashkohen në një program i quajtur Projekti gjithëpërfshirës i arsimit në gjuhën angleze. Si rezultat i kësaj, Korpusi i Paqes filloi vendosjen e vullnetarëve nën dy qëllime të veçanta, një për të ndihmuar nxënësit të mësojnë gjuhën angleze, dhe tjetri për të përkrahur përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla. Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut po e implementon Projektin gjithëpërfshirës të arsimit në gjuhën angleze në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Maqedonisë së Veriut dhe Byronë për zhvillim të arsimit, si dhe me agjensione dhe organizata tjera të përkushtuara për përmirësimin e mundësive arsimore për këta nxënës të marginalizuar.

Qëllimet e Projektit gjithëpërfshirës të arsimit në gjuhën anglez janë: përmirësimi i mësimdhënies në shkolla, rritja e suksesit të nxënësve në mësimin e gjuhës angleze, forcimi i aftësive jetësore të nxënësve, përmirësimi i komunitetit shkollor, si dhe rritja e aftësive të shkollave për të aplikuar praktikën e klasës gjithëpërfshirëse, rritjen e aftësive jetësore dhe praktikave profesionale dhe përmirësimin e kapacitetit në përkrahje të përfshirjes në komunitet.

Aktivitetet e mëposhtme ishin prioritet i vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe i arsimtarëve si bashkëpunëtorë të tyre në vitin 2019:

- Ligjëratë e përbashkët me arsimtarët e gjuhës angleze;
- Futja e metodave për vënien e nxënësve në qendër të orës mësimore;
- Përgatitja e materialeve për orën mësimore;
- Mbështetja e arsimtarëve në zhvillimin e metodologjisë së punës me nxënësit me aftësi të kufizuara;
- Mësimdhënie në anglisht jashtë shkollës, në klube dhe aktivitete të tjera të lira;
- Të ndihmuarit e shkollave me aktivitete të projektit.



## Promovimi i jetesës së shëndetshme – Vullnetari Majkëll Roderik



Si pjesë e Programit për Grante të Vogla të Korpusit të Paqes, vullnetari Majkëll implementoi projektin “Promovim i jetës së shëndoshë” me qëllim që të edukojë vajzat në Shkollën Fillore “Koço Racin” në Kratovë për elementet e shëndosha të jetesës që kanë të bëjnë me praktikën e higjienës së duhur, ushqimit të shëndoshë dhe të qenurit më aktiv.

Si pjesë e projektit, Majkëll, bashkëpunëtorët e tij dhe partnerët e tjerë lokal organizuan një seri të trajnimeve, duke përfshirë këtu trajnime mbi shprehitë e shëndosha për fëmijët, jetesë e shëndetshme (me informata mbi situata faktike në vendin tonë, idea për kapërcimin e sfidave shëndetësore, fake apo mite, lojëra tradicionale në natyrë, siguria elektronike (Interneti/Mediat elektronike), inteligjenca emocionale, etj.), shëndeti në pubertet (ndryshimet biologjike, higjiena), trajnime mbi përdorimin e pajisjeve në mënyrë të duhur, si dhe ushqimi i shëndetshëm.

Një pjesë e madhe e anëtarëve të komunitetit ishin të kycur dhe e përkrahën Projektin për jetesë të shëndoshë, duke filluar prej vetë nxënësve deri tek prindërit e tyre, mësuesit, gjinekologët lokal, arsimtarë nga Shkolla e Mesme për Turizëm dhe Hoteleri, etj. Gjithësej 22 prindër ishin pjesë e dy trajnimeve (në kohëra të ndryshme) dhe më shumë se gjysma prej tyre kanë deklaruar se kanë mësuar diçka të re për shprehitë shëndetësore. Trajnimi për shëndetin në pubertet ishte i udhëhequr nga gjinekologu lokal i cili bëri punë të mrekullueshme në edukimin e nxënësve në tema të ndryshme; si dhe duke u mundësuar hapësirë që të parashtronë pyetje për çështje për të cilat ato ishin kurioze. Rreth 95% e nxënësve kanë deklaruar se kanë mësuar diçka të re për shëndetin në pubertet dhe si mund ta zbatojnë atë në jetën e tyre të përditshme.

Vajzat po ashtu kanë mësuar prej ekspertëve lokal për nutricionizëm dhe gatim të shëndosh. Rreth 81% e nxënësve kanë deklaruar se kanë mësuar diçka të re për nutricionizmin dhe se mund ta aplikojnë në jetën e tyre. Përmes një trajnimi interaktiv të udhëhequr nga një mësuesi i turizmit dhe hotelierisë i cili kishte të bëjë me gatimin prej nxënësve në kuzhinën e një konvikti, kuzhinat e të cilit përdoren nga nxënësit e shkollave të mesme, 90% e nxënësve kanë deklaruar se kanë mësuar diçka të re për gatimin e shëndetshëm dhe si mund ta zbatojnë atë në jetën e tyre. Në fund, 100% e nxënësve pjesëmarrëse kanë deklaruar se kanë hasur njohuri për jetesën e shëndoshë (duke përbushur qëllimin tonë për më së paku 75%). Ky projekt nxiti kuriozitet dhe vullnet që të vazhdohet të mësohet me 24 vajza duke u lajmëruar për Klubin Javor të Jetesës së Shëndetshme që filloi në shtator 2019.

## Ndërtim i kapaciteteve përmes rritjes së shëndetshme në Shoqatën e Skautëve – Vullnetari Aleks Fam



Në fillim të shërbimit tim, pranvera e vitit 2019, bashkëpunëtori im dhe unë mësua shumë për njëri tjetrin. Ne kalonim shumë prej bisedave tona duke folur për burgerë dhe akullore, mësonim, analizonim, vlerësonim dhe ëndërronim. Misioni i parë i Korpusit të Paqes është “Të ndihmojmë njerëzit e vendeve të interesuara për të përmbushur nevojën e tyre për burra dhe gra të interesuara.” Qëllimi i Lëvizjes së Skautëve “...është të kontribuojë në zhvillimin e njerëzve të ri...” Me këta dy misione dhe

qëllim, ne erdhëm në përfundim të rrisim “Ndërtimin e Kapaciteteve” tek liderët e rinj në “Shoqatën e Skautëve në Maqedoni.”

Në vjeshtën e vitit 2018, ne punuam me një fokus grup prej liderëve aktual të rinj në shoqatë për zhvillimin e një kornize të qëndrueshme të trajnimit. Për të implementuar këtë ne krijuam një plan projekt dy-vjecar të quajtur “Rritje e shëndetshme të Skautët”. Ne kërkuam ndihmë prej një organizate që beson në zhvillimin e liderëve të rinj dhe ishim të aftë të bëhemi partnerë me “Fondacionin Ndërkombëtar të Skautëve të Shteteve të Bashkuara”. Kishim qëllim të rrisim kapacitetin e organizatës për liderët e trajnuar të implementojnë një programe kualitative rinore. Pasi që kaluam pranverën e vitit 2019 duke punuar me liderët e rinj të skautëve në zhvillimin e programit mësimor të “Trajnimit Nacional për Leadership” nën tetë shtyllat e “Metodave të Skautëve”

“Shoqata e Skautëve në Maqedoni” ishte bartëse e pilot trajnimit një javor në vitin 2019. Rreth 30 skautë nga e tërë Maqedonia e Veriut, së bashku me 10 skautë udhëheqës të trajnuar u mbledhën në Qendrën Nacionale të Skautëve në Ohër. Gjatë trajnimit, skautët mësuan dhe zhvilluan njohuritë më thelbësore të gjasthtë aftësive kyçe të leadershipit: komunikimit, ndërtimit të ekipit, zgjidhjen e problemeve, vendimmarjen, fuqizimin dhe empatinë. Ata ishin pjesë e trajnimeve për aftësi të transferueshme pune në planin vjetor, planifikimin e takimit të patrulimit dhe trajnimeve për dizajn dhe zhvillim.

Si pjesë e projektit për të vënë në praksë nga trajnimi kombëtar i leadershipit, skautët e sapo trajnuar u kthyen në korrik në Ohër për të realizuar kampin e tyre të parë kombëtar të verës. Këta skautë planifikuan dhe e zbatuan tërë programin e kampit veror për 130 pjesëmarrës prej qyteteve dhe komuniteteve nga secili regjion në Maqedoninë e Veriut. Pas përfundimit të programit veror, ata u rikthyen në grupet e tyre të skautëve, të fuqizuar të drejtojnë programet rinore në komunitetet e tyre. Vitin e ardhshëm, këta liderë skautë të njëjtë do të rikthehen së bashku që të planifikojnë dhe zbatojnë trajnimin kombëtar të leadershipit për vitin 2020 për grupin e ardhshëm të liderëve të rinj dhe do të vazhdojnë të rrisin ndërtimin e kapacitetit tek liderët e rinj në Shoqatën e Skautëve në Maqedoni.

# 44

## vullnetarë shërbejnë në OJQ, komuna dhe institucione publike

### Dëshmi e Arianit Xhaferit – bashkëpunëtor i vullnetares

Ne ishim shumë të lumtur të kemi mundësinë të aplikojmë për vullnetar të Korpusit të Paqes dhe jemi të kënaqur që e kemi pranuar Danielën në ekipin tonë. Ajo ka qenë me Eco Guerilla prej dhjetorit të vitit 2018 dhe më duhet të them se ajo me të vërtetë na ka ndihmuar. Daniela po bashkëpunon me më shumë ekipe të aktivistëve dhe vullnetarëve dhe gjithmonë na informon në organizatë për progresin, sfidat dhe pengesat (nëse ka të tilla) dhe po ashtu diskuton idetë dhe mënyra të reja që do të bëjnë punën tonë edhe më të suksesshme. Ajo është një pasuri e vlefshme për organizatën dhe mua më vjen shumë keq që nuk mundemi ta kemi në Tetovë përgjithmonë! Dhe jam i sigurt se kështu mendojnë edhe shumë prej miqve të saj në Tetovë.



### Dëshmi e Rugova Kurtishit – bashkëpunëtoresh e vullnetares



Përvoja e mëhershme e Danielës në kordinimin dhe menaxhimin e projekteve ishte një vlerë e madhe për zhvillimin lokal të departamentit në komunën e Tetovës. Ajo ka qenë komunikatore për OJQ-të në Tetovë. Në bashkëpunim me kolegët nga LED ajo ka pasur takime me njerëz nga shoqëria civile dhe ka krijuar një formë në faqen e internetit të komunës ku OJQ-të mundën të regjistrohen vetë.

Në kornizën e projektit “Fuqizimi i këshillave komunal” në komponentën e tretë që është transparenca, së bashku me Danielën ne kemi krijuar një platformë ku qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset mund të ndajnë idetë e tyre, të propozojnë shërbime dhe të angazhohen në identifikimin e komunitetit.

Partneriteti ynë me Danielën ka qenë një eksperiencë e paharrueshme. Duke i pasur parasysh vështirësitë e të jetuarit jashtë vendit, unë jam përpjekur që t'i

ndihmoj aq sa ka qenë e mundur, ashtu që ajo të ndjehet pjesë e komunitetit tonë. Unë kurrë nuk e kam parë atë vetëm si një vullnetare të Korpusit të Paqes, por si një kolege të mirë dhe një shoqe të shkëlqyeshme.

## Emri i projektit: Dr. Seuss Night – Vullnetarja Aleksa Çamberlin

Unë isha vullnetare në Tri Çeshmi, një fshat afër Shtipit. Gjatë kohës time aty, unë i mësoja anglisht nxënësit prej klasës së parë deri në klasë të nëntë. Ne zhvilluam dy grante, një për të krijuar një klasë të nevojshme të gjuhës angleze dhe një për të krijuar bibliotekën e klasës. Pasi e krijuam bibliotekën ne dëshironim që prindërit të shohin klasën tonë të re, të jenë të kycur me shkollën dhe të promovojnë arsimim. Që të arrijmë qëllimet tona, unë dhe bashkëpunëtorët e mi planifikuam të bëjmë një natë familjare për prindërit dhe nxënësit.

Në shkurt vendosëm që tema e natës tonë familjare do të jetë Dr. Seuss.

Secila gjeneratë kishte për detyrë të performojë nga një dramë ose këngë që është e ndërlidhur me librin e Dr. Seuss. Në klasë ne lexonim librat e Dr. Seuss, bënim dekorime dhe nxënësit ushtronin performanset e tyre. Natën e planifikuar, nxënësit dhe stafi performuan këngët dhe shfaqjet e tyre para 30 prindërve! Pas performansave, nxënësit kalonin nëpër stacione të Dr. Seuss të luajnë lojra, të zgjidhin STEM sfida, të lexojnë libra dhe të bëjnë zeje me prindërit e tyre. Kjo ishte një ngjarje e suksesshme sepse të gjithë nxënësit kishin marrë pjesë dhe kishim mbi 30 prindër që ishin pjesëmarrës dhe shumë prej prindërve kërkuan në të ardhmen të ketë më shumë nata prindërore.



Pas ngjarjes, nxënësit dhe familjet ishin të mahnitura dhe dëshironin të kenë më shumë mundësi të lexojnë në klasë dhe jashtë klasës. Ne i ndihmuam nxënësit të gjejnë nivelet e tyre individuale të leximit dhe ne i niveluam librat në bibliotekën tonë klasore. Pasi u përfundua biblioteka jonë, ne zhvilluam një sistem i cili u lejon nxënësve të të gjitha gjeneratave të huazojnë libra dhe t'i lexojnë ato në shtëpi. Bashkëpunëtorja ime Marina, po ashtu krijoi një klub lexues ku nxënësit më të vjetër u lexojnë libra nxënësve më të rinj secilën javë. Kjo kishte shërbyer si program i mbikqyrjes që promovon gjuhën angleze dhe leximin. Ne e dinim se sa më shumë nxënësit tanë lexojnë, aq më shumë anglishtja e tyre do të përmirësohet dhe kur nxënësit e kuptuan këtë, ishte zbavitëse të ushtrohej anglishtja e tyre. Ne besojmë se nata e Dr. Seuss ishte një hap i parë i shkëlqyeshëm të motivojë leximin me prindërit dhe nxënësit.



## Emri i projektit: Klasa e kitares – Vullnetari Vesli Kosvara

Unë luaj kitaren dhe disa nga nxënësit e mi kanë shprehur interesim që të mësojnë më shumë për kitaren nga dikush që ishte i aftë ta luante. Në fillim, unë mendova të aplikoj për grant që të mundemi të blejmë kitara për nxënësit që nuk kishin dhe dëshironin të mësonin, por më vonë mendova që ndoshta është më mirë të filloj me një grup të vogël që tashmë ishte i interesuar.



Çdo javë të enjteve unë takohesha me nxënësit e mi në klasë dhe i mësoja për kitaren. Unë kam gjashtë nxënës gjithësej, në nivele të ndryshme. Çdo javë përpiqem të plotësoj nevojat e nxënësve të mi në nivelet e tyre të ndryshme. Edhe cingëllima edhe teknika e gishtërinjve mësohen në këto orë. Ndonjë këngë specifike që nxënësit dëshirojnë ta mësojnë ushtrohet në orë ose punohet individualisht pas ore.

Unë jam shumë i lumtur me miqësinë që e kam zhvilluar me nxënësit e mi si rezultat i orëve, si dhe me progresin e tyre me instrumentin. Ora mbahet në anglisht, kështu që të gjithë prej tyre kanë shansin të ushtrojnë aftësitë e tyre gjuhësore. Jashtë orës së kitares, në orën e mësimin, këta nxënës janë më të motivuar dhe më të sigurt në aftësinë e tyre për të komunikuar. Unë shpresoj që do të ju jap një bazë themelore muzikore në të cilën pastaj ata do të ndërtohen muzikalisht, që do të jenë të aftë ta bëjnë pasi që unë të shkoj. Gjithashtu shpresoj që ushtrimi shtesë i anglishtes me një folës amtar do të ju jap vetëbesim dhe dëshirë të vazhdojnë të përkryejnë aftësitë e tyre gjuhësore edhe jashtë klasës.

## Tregimi i familjes nikoqire – Vullnetarja Kendall Priç

Kendall ishte TEFL vullnetare në një fshat afër Kumanovës. Kendall i tha teta Bllagicës, nënës nikoqire që jetonte vetëm, se ajo kishte qarë shumë kur e ka kuptuar që do të jetojë në fshat, ndërsa tani nuk do ta ndryshonte me asgjë.

Ajo e mësoi teta Bllagicën se si të bëjë supë prej kungujve, ndërsa teta Bllagica e ka mësuar atë si të bëjë kiflet dhe specat të mbushur. Çdo herë që familja shkonte në fushë për të mbjellur groshë ose të punojë në vreshta,

Kendall shkonte me ta. Teta Bllagica fliste me familjen e saj çdo natë. Babai i saj erdhi ta vizonte. Ata ende kanë kontakt dhe teta Bllagica me të vërtetë po e pret Kendall të rikthehet.



## Tregimi i familjes nikoqire – Vullnetarja Kenan Krejg

Sapo u shpërngula tek failja ime nikoqire pas trajnimit, e dija që do të ishte si një shtëpi e vërtetë për mua. Ata më bënë të ndjehem si një anëtare e vërtetë e familjes së tyre që nga vetë fillimi. Ata



siguroheshin që unë të isha pjesë e aktiviteteve ditore, si pirja e kafes së bashku dhe vizita e fqinjëve. Ata më njohën mua me ushqimin e tyre, muzikën, traditat, zakonet dhe festat dhe gjithmonë ishin të gatshëm të përgjigjen pyetjeve që unë kisha si dhe të më ndihmonin të përmirësoja aftësitë e mia gjuhësore. Verën e kaluar, një kusheri i familjes time nikoqire u martua dhe ata më ftuan që të marr pjesë në dasëm njëjtë si motra ime nikoqire. Unë veshja një fustan tradicional, i mësova vallet dhe këngën që ia kënduam nuses dhe dhëndrrit dhe u njoha me të gjithë familjen. Ishte një eksperiencë e mrekullueshme dhe kujtimet që i kam nga ajo javë përgjithmonë do të jenë të veçanta për mua. Ishte shumë e dobishme të përjetosh zakonet e dasmës sepse më mësoi shumë për kulturën e dasmave tek shqiptarët. Unë me të vërtetë besoj se e kam gjetur familjen time të dytë gjatë shërbimit tim në Korpusin e Paqes dhe përgjithmonë do t'i gëzohem asaj dhe kohës që e kemi kaluar së bashku.

## Dëshmi e Katerina Llukarovës – Bashkëpunëto e vullnetarit

Të jesh bashkëpunëtor i vullnetarit të Korpusit të Paqes është një mundësi që secili arsimtar i gjuhës angleze në vendin tonë duhet të dëshirojë dhe të pranojë. Është një sfidë e vërtetë edhe për nxënësit dhe arsimtarin në një rën anë, ndërsa në tjetrën për vetë vullnetarin. Është një rast me shumë përparësi dhe me shumë pak ose aspak pengesa.

Prej momentit të parë të takimit me vullnetarin, është një lumturi e pafund për nxënësit dhe për prindërit e tyre gjithashtu. Nxënësit bëhen më të vetëbesueshëm, më shumë punojnë, më mendjehapur dhe më pak të turpshëm dhe introvertë. Paprimtas ata dëshirojnë të jenë në shkollë për më shumë orë dhe të punojnë dhe të flasin me vullnetarin. Ata janë të interesuar për gjithcka çka vullnetari kërkon prej tyre të bëjnë në klasë, si dhe jashtë klasës, pasi që vullnetari gjithmonë ka shumë lojëra interesante dhe mënyra të ndryshme të mësimit dhe bërjes së hulumtimeve.



Deri tani, unë dhe shkolla ime, kemi pasur rastin të presim dy vullnetarë të Korpusit të Paqes të cilët kanë ndihmuar nxënësit tanë që të përmirësojnë anglishten e tyre, veçanërisht aftësitë e të folurit. Falë tyre ne kemi pasuruar bibliotekën tonë shkollore me shumë libra interesante, fjalore dhe libra të gramatikës. Ne kemi krijuar Klubin e të folurit, Klubin e leximit dhe Klubin e shkrimit. Nxënësit e Klubit të të folurit kanë punuar aq shumë, sa që ne jemi paraqitur të jemi pjesë e Kupës Botërore të Nxënësve. Nxënësit e Klubit të shkrimit kanë qenë pjesë e Sfidës Kombëtare për Ese në Gjuhën Angleze dhe ne kemi fituar çmimin e dytë dhe kemi marrë pjesë në shumë gara tjera dhe debate në Këndin Amerikan në Shkup.

Plani ynë për verën ishte të organizojmë një Kamp Udhëtimi dhe të dërgojmë disa prej nxënësve tanë të klasës së nëntë në GLOW dhe YMLP kampet. Ne po ashtu kemi dashur që nxënësit të jenë më aktivë gjatë verës duke punuar në projekte jashtë shkollës, si për shembull ngjitja në malin e Vodnos, vizitë në kopshtin zoologjik, çiklizmi dhe disa orë të vizatimit pasi që vullnetarja jonë Liz është një piktore e mrekullueshme dhe disa gjëra të tjera për ta. Ne shpresojmë se do të kemi shansin të bëjmë këtë të mundur.

## Dëshmi e Marina Spasovës – Bashkëpunëtores e vullnetarit

Gjatë 16 muajve të fundit, Shkolla Fillore “Sllavço Stojmenski” ka pritur një TEFL vullnetar të Korpusit të Paqes nga Kentaki. Filip Lenç dhe unë kemi qenë partnerë në shumë projekte të përbashkëta jashtë rutinës tonë ditore të aktiviteteve mësimore, dhe po ashtu jemi bërë shokë shumë të mirë. Shkolla jonë së fundi ka krijuar një Klub Muzikor të Anglishtes që pas shkolle nxënësit vijnë së bashku dhe mësojnë këngë në anglisht dhe këndojnë në kor. Kur Filipi u bashkangjiti, ai propozoi idenë që të organizohet një koncert lokal në Shtëpinë e kulturës në Vinicë, ku nxënësit do të performojnë këngë dhe valle për mysafirët e pranishëm. Të ardhurat nga koncertet në gjysmëvjetorin veror dhe atë dimëror kanë shkuar për shkollën, dhe të dy koncertet ishin të suksesshëm!



Filipi po ashtu më ka ndihmuar me pjesën tjetër të projekteve që unë i kam inicuar, si për shembull Klubi shkollor i ambientalizmit dhe pas shkolle duke mbajtur klasa tutoriale në Kryqin e Kyq. Ne kemi punuar me nxënës të klasave të ndryshme, prej klasës së parë deri te e nënta dhe kemi mësuar mënyra të ndryshme se si të qasemi në varësi nga mosha e nxënësit. Si shtesë, Filipi ka motivuar më shumë një qasje të folurit në plan programin e gjuhës angleze, që ishte një plotësim i mirë për ushtrimet e të shkruarit dhe të lexuarit që ne i kishim.



Në përgjithësi, Filipi dhe unë kemi punuar shumë mirë së bashku. Ne të dytë kemi pasur një qasje të shtrënguar kur ka pasur probleme për tu zgjidhur dhe kurrë nuk kemi pasur grindje apo zemërim brenda ose jashtë klasës. Ne ishim në fazën fillestare të aplikimit për grant nga Korpusi i Paqes për krijimin e një qendre të gjuhës angleze në katin tonë të poshtëm të shkollës, por pandemia e korona virusit na i ndërpreu ato plane. Ne ishim të mërzitur të shohim Filipin të shkojë më herët se sa që duhej, por jemi shumë falenderues për gjithçka çfarë ka kontribuar për shkollën dhe komunitetin tonë. Ai është bërë një prej miqve të mi më të mirë dhe familja ime gjithmonë do ta kujtoj atë si një njeri të mirë dhe një anëtar i familjes tonë. Ai gjithmonë do të ketë shtëpi këtu në Vinicë.



# Programi i praktikës në Korpusin e Paqes

Përveç punës të vullnetarëve tanë në komunitetet e tyre, Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut në mënyrë direkte e përkrah zhvillimin e punësueshmërisë të të rinjve përmes Programit të tij të praktikës i filluar nga viti 2017. Ky program rinor u ofron studentëve lokal të universiteteve ose të sapo-diplomuarve mundësinë të jenë të ekspozuar në punën e Korpusit të Paqes në Maqedoninë e Veriut dhe të zhvillojnë aftësi të përkrahjes administrative për një karrierë të sukseshme në të ardhmen. Praktika e Korpusit të Paqes zgjat prej gjashtë deri në nëntë muaj, në varësi nga nevojat tona të punës dhe disponueshmëria e praktikantit. Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut punon për së afërmi me njerëzit me nevoja të posaçme në vend. Këtë vit në zyrat tona e mirëpritëm Okin, një djalë të ri me sindromin Down. Oki erdhi si praktikant dhe na dëshmoi se sa të aftë janë njerëzit me nevoja të posaçme. Deri tani Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut e ka pasur kënaqësinë të ketë 16 praktikantë në zyrat tona. Më poshtë ju mund të lexoni për përvojën e praktikantëve tanë të fundit, Nikolla, Gjurgjica dhe Oki.



Peace Corps



Nikolla Donev

Detyra lartësuese e ndërtimit të paqes është një detyrë që e teston zemrën, mendjen dhe shpirtin e burrave dhe grave në kohë dhe hapësirë, por megjithatë, besimi i fortë në kauzën e paqes do të japin rezultate – kjo është historia e Korpusit të Paqes që hapëron botën, dhe jam falenderues të jem pjesë e vogël e kësaj historie të madhe.

Historia ime me Korpusin e Paqes fillon në komunitetin tim lokal ku unë njoha vullnetarë dhe u angazhova në punën e tyre. Gjatë viteve duke punuar me vullnetarë të Korpusit të Paqes ata janë bërë disa prej mentorëve dhe miqve të mi që kanë pasur gisht në formimin tim dhe atë se kush jam sot.

Koha si praktikant në zyrat e Korpusit të Paqes në Shkup ishte një privilegj të shoh punën e brendshme të Korpusit të Paqes dhe si vullnetarët dhe stafi punojnë së bashku përderisa përpiqen të integrojnë grupin e ri të vullnetarëve në komunitetet e tyre, dhe si ata i ndihmojnë vullnetarëve tashmë të vendosur në punën e tyre. Praktika ishte mundësi edhe të kthehem tek Korpusi i Paqes duke ofruar ndihmën time përderisa stafi po mirëpriste grupin MAK24 të vullnetarëve, si dhe të shoh punën e MAK23 vullnetarëve në konferencën në mes të shërbimit të tyre.

Ashtu si detyra lartësuese e Korpusit të Paqes vazhdon edhe në kohëra të dëshpërimit dhe pasigurisë, këmbëngulja është më e rëndësishme se kurrë më parë, dhe ekzistenca e Korpusit të Paqes qëndron si një simbol i vërtetë që paqja mundet të nxitet vetëm nga njerëzit, prej njerëzve dhe për njerëzit.

# Programi i praktikës në Korpusin e Paqes

Praktika në Korpusin e Paqes ishte një eksperiencë e papërsëritshme në jetë. Ditët nuk ishin kurrë të mërzitshme ose të bezdisshme sepse ato ishin të mbushura me detyra për t'u kryer dhe me njerëz për të folur.

Gjatë shtatë muajve që unë kam kryer praktikën këtu, e kisha mundësinë të mësoj dhe të ndihmoj në atë se si kjo familje e madhe e bën çdo gjë të mundur. Nuk është detyrë e lehtë të bëhesh gati për vullnetarët, të mendosh për çdonjërin dhe të jesh këtu për secilin person, por ata e menaxhuan në mënyrë të përkryer me përkrahjen që e kanë nga njëri tjetri. Ditët e mia ishin të mbushura me detyra që më ndihmuan të njoh njerëzit këtu, më ndihmuan të mësoj shkathtësi të reja, të përmirësoj aftësitë e mia komunikative dhe të përgjithshme. Unë kisha mundësinë të flas me disa prej vullnetarëve dhe të bëhemi miq. Nuk kishte ditë kur stafi nuk na falenderonte për diçka që kemi bërë, pa dallim a ishte punë e madhe apo e vogël, që më bëri të kuptoj se edhe kontributi më i vogël bën ndryshim. Zyra ishte gjithmonë e mbushur me qeshje dhe biseda të gjalla, duke i bërë mëngjeset e mia freskuese dhe gëzuese. Koha ime në Korpusin e Paqes ishte e jashtëzakonshme dhe duke e kaluar këtë kohë me Nikollën e bën edhe më të veçantë dhe të paharrueshme.



Gjurgica Temellkova



Orhan Amit—Oki

Oki ishte shumë i lumtur dhe i gëzuar kur ai filloi praktikën e tij me Korpusin e Paqes. Ai shkante me gëzim në punë dhe nuk mundej që të preste ditën tjetër që të vij. Ishte një përvojë e shkëlqyeshme për të, pasi që kjo ishte mundësia e tij e parë të ndihmojë me punë në zyrë dhe të dëshmojë që ai mundet. Pas çdo dite të kaluar në Korpusin e Paqes, ai kthehej në shtëpi me një buzëqeshje të madhe në fytyrën e tij dhe me gëzim na tregonte të gjithëve se çfarë kishte bërë në punë.



# Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut në 2019



109

vullnetarë shërbyen në 2019

44



Vullnetarë shërbyen në OJQ, komuna dhe institucione publike



65

shkolla fillore dhe të mesme ku vullnetarët shërbyen



114

Mësues prej shkollave fillore dhe të mesme me të cilët vullnetarët punuan



14

Kampe përreth botës



24

vite në Maqedoninë e Veriut

1099



pjesëmarrës në aktivitetet e komunitetit



291

përfitues me nevoja të vecanta



10219

Nxënës të mësuar nga vullnetarët

56

Komuna ku vullnetarët shërbyen



4



ngjuhë lokale të cilat vullnetarët i mësuan



63


Organizata të Shoqërisë Civile të cilat punuan me vullnetarët

# Shërbimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes në bazë të Regjionit



**Peace Corps**

NORTH MACEDONIA



**89**

Familje nikoqire kanë pritur vullnetar



e të gjithë vullnetarëv e kanë shërbyer në zonat rurale

